

Shfletimi i kujtimeve te mia mbi disa veprimtari kombetare  
te Kryetarit te Shoqates se pare te Egjiptianeve te Kosoves,  
te ndjerit VESEL KODROLLIT

Zoterinje te nderuar,

Me rastin e ndarjes nga jeta te te ndjerit VESEL KODROLLIT, Kryetarit te Shoqates se pare te Egjiptianeve te Kosoves, ne emer tim i shprehi ngushellimet e mia me te sinqerta dhe me te thella familjes Kodrolli, bashkepuntoreve , miqeve dhe kolegeve te tij.

Inshalla All-llahu i madheruar me te ndjerin na perpjek ne xhenet.

Veprimtaria e te ndjerit VESEL KODROLLIT eshte e gjere , sepse ai si strateg dhe kolos i ceshtjes sone kombetare Egjiptiane, i perkrahur nga shoket, punoi dhe veproi ne kohe dhe rrethana te veshtira, dhe barti barren me te larte por me te cmuar - Timonin e Shoqates se pare te Egjiptianeve te Kosoves, qe e udheheqi me guxim dhe menquri plot nje decenje me radhe.

Prandaj, per ti pershkruar tera veprimtarit e kesaj dekade te te ndjerit VESEL KODROLLIT na duhen kohe te tera, e une per shkak te kohes do te mundohem ti kujtoj vetem disa nga ato duke filluar qe nga fillimi i organizimit te Levizjes sone Egjiptiane.

Mue me te ndjerin VESELIN na ndajshin disa dhjetra kilometra e nuk njifeshim mes vete, por ceshtja kombetare na njoftoi dhe bashkoi , jo vetem mua me te ndjerin, por edhe shume aktivista tjere mes njeni tjetrit.

Se pari here me Veselin u njoftova permes shokut, tim te ndjerit HALIT ISAKU, nga Rahoveci, i cili ishte antar i Levizjes sone kombetare Egjiptiane. Takimin e bame ne darsmen e marteses se djalit te Basri Hoxhe Peqanit ne Fushe Kosove, i cili e financoi fillimin e Levizjes sone Egjiptiane. Ne darsmen Haliti me prezantoi te Veseli dhe u ulem te trete se bashku. Te rinjet tane porositnin kenge dhe valle mbi egjiptianet. Basri hoxhe Peqanit i behej qejfi, sepse te rinjet Egjiptiane duke kenduar kenge mbi Levizjen tone patriotike Egjiptiane dhe duke luajtur ia hijeshojshin dhe zmadhojshin dasmen . Edhe Veselit i behej qejfi, edhe Ai percillte kenget e te rinjeve dhe nganjehere vallezone. Keshtu qe te Veseli verejta se ai eshte kombedashes dhe mund te bisedohet me te. Andaj, dikur gjeta kohe dhe Veselin e njoftova mbi Levizjen tone. Kjo Levizje mbi zgjedhjen e halleve te popullit tone Veselit i flejti ne shpirt , dhe na ftoi qe te dilen e ardhshme te shkojme te ai ne banese ne Vushtrri e te bisedojme gjere e gjate.

Erdhi e dielja dhe se bashku me te ndjerin Rrahman Miftarin, Agim Ramadanin, Sabri Mustafen dhe disa te tjere shkum te Veseli ne Vushtrri ku ishte duke banuar. Posa mbaroi biseda e lire mes neve, filluem te bisedojme mbi rendesine e Levizjes sone kombetare, qe te deklarohemi ne menyre te drejte, e jo te skuqur te deklarohemi dicka qe ne te vertet nuk jemi . Biseden rreth kesaj Levizje Veseli e priti ngrohesisht dhe shtoi:

- " Vertete tani eshte me se e nevojshme qe edhe ne te percaktohemi ne menyre kombetare, e jo te shetisim here ne njenin e here ne tjetrin kombesi e ne anen tjetet te jemi te trajtuar dhe te perburur me emra nencmues. Nuk duhet ma te mashtrohemi e ta quajme veten ende dicka qe ne te vertet nuk jemi. Te tjeret e dijne mire se kush jemi por e meshefin te verteten e na perziejne me te tjeret, sepse atyre vetem ashtu ju konvenon.

- Me ju thane te drejten, shtoi Veseli, mue qysh si student me preokuponte ceshtja kombetare, dhe gjate regjistrimit shtetror te popullsesise te vitit 1981 u regjistrova si musliman, ku deklarimit musliman iu bashkuan edhe te gjithet e afermit e mi dhe fqinjat e tjere te perkatesise sone, e qe per kete pastaj pata probleme te medha. E tash erdhi koha kur po jetesohen kerkesat e te pareve tane per pranim te kombit tone. Prandaj, prej sodit edhe une do te jam me juve - pjese perbese e kesaj Levizje mbi percaktim te identitetit tone kombetar dhe do ta jap kontributin tim", tha Veseli.

Takimi i radhes me Veselin u ba ne banesen time ne Prishtine, e cila pastaj u ba vater shkembimi idesh te ceshtjes sone kombetare per Egjiptianet kosovare. Ne kete takim moren pjese si gjithehere shume antare te kesaj Levizje ku merrnin detyra per ti zbatua ne teren me popull.

Antaresia e kesaj Levizje shtohet gjithëherë e me shumë dhe pas disa muajve filluam pregaditjen për mbajtjen e Kuvendit themelues të Shoqatës Egjiptiane të Kosovës në Prishtinë, si fole që tubonte njëzet e ngritur.

Konsultoheshim se kush do të kandidohet në Kryesinë dhe kënd do ta zgjedhim për Kryetar të kesaj Shoqate. Te gjithë ishim të mendimit që Veselin ta zgjedhim për Kryetar, të cilit edhe ia shprehëm atë mendim, e Ai tha:

- "Falem nderit për besimin që më ofroni, por merita është e juaja që dikush prej juve të zgjidhet Kryetar, sepse ju jeni ata të parët që filluat këtë Levizje".

Kështu që më datën 21.10.1990, u mbajtë Kuvendi Themelues për formimin e Shoqatës së Egjiptianëve të Kosovës, ku morën pjesë me se 150 delegatë nga mbare Kosova, dhe me vota unanime u zgjodhë Kryesia, e për Kryetar të Shoqatës u zgjodhë Vesel Kodroli, i cili e mirepritë këtë detyrë duke shtuar se "më ndershmeri do të punoj për suksesin im mbarë nga masa popullore që më perkrah".

Ardhja e Veselit në mesin e Levizjes sone Egjiptiane na dha fuqi, por edhe më të fuqishëm ishim kur u vë në krye të Shoqatës sone Egjiptiane të Kosovës si Kryetar, dhe plot një dekadë më radhe i mbeti besnik çështjes sone kombëtare.

Ishte knaqesi dhe ndere e madhe të punojmë me të si ideolog dhe patriot i madh i Egjiptianëve kosovare, sepse, si Kryetar në cdo Tubim të Kryesisë sone na dhajkë kurajo duke na rritë moralin e ndjenjës sone kombëtare egjiptiane dhe duke na udhëzua se si duhet të punojmë me popull.

Gjate udhëheqjes së kesaj Shoqate ishte i gjithanshëm: merrej me shkrime të ndryshme në prozë dhe poezi ku trajtonë mjerimet e popullatës sone, pastaj së bashku me shokë hulumtonë gjurmët e të parëve tanë në treva të Kosovës, e pastaj i publikonë në Revisten tonë "Zeri i Egjiptianëve Jugosllavë".

- Veseli më bashkëpunëtorët e vetë së pari herë u takua me Ambasadorin e Ambasadës së Egjiptit në Beograd z. Hysen Hasouna në vitin 1992. Takimi u organizua në Ohër nga Shoqata e Egjiptianëve të Maqedonisë me në krye z. Nazmi Arifin dhe Hysni Zemoski, pa mundin e të cilëve deklarimi Egjiptian në Kosovë dhe Shqipëri nuk do të egzistonte, dhe pozita e popullit tonë do të ishte e njëjtë si në gjendjen e mëparshme. Veseli ishte i rregullt në kontaktet tona me shkenctarët, kështu që Ai së bashku më mua, Ragip Berishën, Agim Ramadanin dhe Hakif Berishën, kontaktoi më Prof.dr. Skender Rizaj. Profesori pritjen e bëri në shtëpinë e tij, dhe ishte i interesuar mbi paraqitjen e minoritetit tonë Egjiptian në Kosovë. Pasi Veseli e informoi në tërsi mbi ekzistimin e minoritetit tonë, profesori nxori një punim që kishte pregadit për botim dhe tha se "ky liber i përshkruan popujt e vjetër në Ballkan ku bëni pjesë edhe ju Egjiptianët, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare ende nuk është botua". Prof. Skender Rizaj spjegonte Hieroglifet, tregonte për Nermina Flora Falaqin e cila iu kishte bashku profesorit Gjyzepe Katapana nga Italia për të punuar në këtë drejtim e shumë gjëra tjera. Biseda jone më profesorin zgjati pesë orë.

- I ndjeri Vesel Kodroli shumë herë kontaktoi më prof.dr. Miodrag Haxhiristiq, etnolog nga Shkupi, i cili kurrë nuk u ndal duke shkruar mbi Egjiptianët në Ballkan. Poashtu, takime të shumta Veseli kishte edhe më prof.dr. Stojan Ristevski, nga Ohër, i cili më kërkesën tonë pranoi që të mbanë tryeze shkencore në Prishtinë mbi përardhjen e Egjiptianëve në Ballkan.

- Më Prof.dr. Rade Bozhoviq, filolog nga Universiteti i Beogradit, Veseli së bashku më shokë u takua gjatë një Tubimi të madh në Shkup ku mbahej "Kultura Islame në Maqedoni". Këtu profesori Rade Bozhoviq në një sallë të posaqme pati rastin të njihet nga Veseli mbi kulturën, traditat dhe adetët e Egjiptianëve kosovare, në bazë të së cilave erdhi në përfundim se kemi përardhje Egjiptiane.

- Veseli rregullisht për cdo vit së bashku më shokë ishte pjesëmarrës në Manifestimin e Dites shtetërore të çlirimit të Egjiptit, që organizohet në Ambasaden e Egjiptit në Beograd nga Ambasadori HANI KHALLAF, i cili ushqente simpati të madhe ndaj Egjiptianëve kosovare.

- Në Qershor të vitit 1997, Atashe për Kulturë zt. AKL ASHKAL nga Ambasada e Egjiptit në Beograd erdhi në Prishtinë që ta viziton Kryesinë e Shoqatës sone. Takimi u zhvillua në Motelin privat që gjindej në Parkun e Muhagjereve në Prishtinë. Në pritje ishin i ndjeri Vesel Kodroli, së bashku më të ndjerin Rrahmon Miftarin, Qerim Abazin dhe Sami Ramadani. Ambasadorin Akl Ashkal e njoftuam në përgjithësi mbi pozitën tonë të veshitë ekonomike dhe politike, e pastaj ai na e bëri këtë pyetje:

- A kishit ardh me jetua ne Egjipt?

Ne u ndrydhem e u shtrydhem dhe nuk dijsim si ti pergjigjemi, e dikur Veseli i tha:

- Zoteri Ambasador, ketu kemi pasuri dhe veshtire e kemi qe te vendosmi ta lajme kete pasuri dhe te vijme ne Egjipt. Por juve ju lutemi qe ta ngritni zerin te nderkombetaret per mbrojtjen dhe sigurin tone.

Perpjekjet e pareshtura te Kryesise se Egjyptianeve Kosovare qe nga themelimi i Shoqates ishte mbrojtja e identitetit etnik te rrezikuar nga gllaberuesit qe donin te na zhbenin nga faqaja e dheut. Kishte nevojte qe te punojme nate e dite pa u ndale, duke kaluar ne ethe te jetes vetem e vetem per te arritur deri te njohja e kesaj popullate me te gjitha te drejtat e saja. Pasi populli shumice ne Kosove krahas kerkesave tona per njohje dhe bashkepunim- na mohoi tete vjete me radhe dhe kurre nuk na pranoi, Veseli se bashku me shoket: Qerim Abazin, Rrahmon Miftarin, Nezir Kelmendin, Hamit Sefedinin dhe Ali Salihun, mori pjese ne Dialogje per zgjidhjen e ceshtjes se Kosoves qe mbaheshin ne Prishtine ne mes te Qeverise se atehershme serbe (1998) dhe pakicave qe jetonin ne Kosove. Ne keto dialogje mirrnin pjese: Turqit, Muslimanet, Romet, Goranet dhe Shqiptaret. Me paraqitjen e Shqiptareve ne keto Dialogje, Kryesia jone u lirua nga keto ethe te kapluara dhe nje muaj ma vone ne mbledhjen e saje - me propozimin e Kryetarit dhe pelqimin e Keshilltarit te saje, ne mbledhje te Kryesise u vendos njezerit qe edhe Kryesia e Egjyptianeve kosovare te merre pjese ne keto Dialogje per ta njoftuar Qeverine serbe mbi ekzistencen tone ne Kosove dhe per te kerkuar te drejta te barabarta me te tjeret. Pas disa dite te mbajtjes se ketyre Dialogjeve, me kujtohet gjate nje mbledhje kur Veseli iu kercnue Qeverise serbe dhe ne menyre demonstrative deshti ta leshon mbledhjen, sepse Qeveria serbe ne nji Program te shkruar kishte ceke te gjitha pakicat qe jetonin ne Kosove, kurse pakicen tone Egjyptiane e kishte harrua. Por pasi Qeveritaret serbe u arsyetuan se ky gabim eshte leshuar nga daktilografi dhe nuk do te perseritet ne te ardhmen, Veseli u ule dhe vazhdoi mbledhjen se bashku me shoke.

Enderra me e bukur e Veselit ishte njohja e identitetit tone kombetar Egjyptian, e Ai me djerse ne balle e mund ne shpirt nderren e vet e beri realitet dhe se bashku me shoke duke vu bazat e kombit Egjyptian, me sukses e vulosi ekzistencen e Egjyptianeve ne Kosove, e cila ekzistence mori permasa nderkombetare dhe ne kete menyre e permbushi misionin e vete jetesor, sepse me aktivitetet e tija se bashku me shoke i dha drite erresires qe na kishte pllakosur.

Sikurse ne shume Shoqata dhe Parti te tjera politike qe lindin probleme dhe xhelozit per shkak te fitimit te pozites me te larte ne Shoqate apo Parti, e qe pastaj per mos sukses, te deshpruar e zbehin aktivitetin e vet, ashtu edhe ne Shoqaten tone kah fundi i dekadës se saje lindi konflikti rreth fitimit (emrimit) te funksionit shteteror. Por duke ditur rendesin dhe vleren e punes sone te shenjet kombetare, mosmarrveshjet tona shpejt u shuan dhe nuk ndikuan ne zbehjen e aktivitetit, por ne angazhimin tone edhe me te madh ne pune.

Keshtu qe se bashku me Veselin iu pergjegjem lutjes se perfaqsesit te Partise IRDK-a Bislim Hotit qe intervenoi permes Hasan Kershit, qe te dalim ne teren dhe ta lusim popullaten tone te ikur nga Kosova qe te votojne per Partin e Egjyptianeve IRDK-a.

Per mua si funksioner i Ministrise se rexhimit te meparshem serb ishte shume veshtire te dal ne popull e te agjitoj per perfaqsesit e kesaj Partie te cilet punonin per pavarsi te Kosoves.

Por per hire te popullit tim dhe identitetit Egjyptian ne Kosove, sakrifikova veteveten dhe vendosa te agjitoj per perfaqsesit e kesaj Partie e qe pastaj me linden probleme, por nuk pendohem.

Keshtu qe me veturen e rexhimit te meparme serbe qe isha i ngarkuar sipas funksionit, se bashku me Veselin, me shpenzime tona shkuem ne Berane, pastaj ne Rozhaj, Nikshiq, Podgoric (konik 1 dhe konik 2), Budva dhe Tivat. U takuam me keta Egjyptiane te ikur dhe i lutem qe gjate Zgjedhjeve parlamentare qe bahen per Kosove, te dalin masovikisht dhe te votojne per Bislim Hotin dhe Partine Egjyptiane IRDK.

Ne fillim kundërshtuan keta te ikur, por me ne fund ne i bindem dhe te gjithë na dhane fjalen se do te dalin ne Zgjedhje dhe do te votojne per Partin IRDK-a. Pastaj shkuam ne Subotic, Novi Sad dhe Beograd, ku edhe aty u pritëm mire nga Egjyptianet tane te ikur te cilet edhe ata na dhan fjalen se do te votojne ashtu siq kerkuam.

Koha erdhi dhe Zgjedhjet e para parlamentare per Kosove filluan. Te rinjet dhe te vjetrit, burrat dhe grat te ikur nga Kosova ne Mal te Zi, Serbi dhe Vojvodine dolen ne Zgjedhje dhe votuan per Partin IRDK-a ashtu siq ishim marre vesh. Ne Beograd se bashku me Veselin shkojshim te Egjyptianet tane neper lagje ku ishin vendos dhe me veture i qojshim qe te votojne.

Pas publikimit të rezultateve, ishim të kënaqur që Partia politike e Egjiptianëve kosovare IRDK-a fitoi dy vende në Parlamentin e Kosovës: vendin e rezervuar të fitoi Bislim Hoti sipas funksionit, e tjetrin e fitoi Xhevdet Neziri sipas votave të arritura. Veseli ishte shumë i kënaqur e thoshte: “ja Qerim po shifet rezultati i punës sonë”. Edhe ndëkombetaret ishin të befalshëm e posaçërisht Hakerupi me numrin e madh të votave të egjiptianëve të arritura nga Serbia dhe Mali i Zi, e që me vone u desh mua me dokumentin e OSB-se”.

Por Veseli ishte i dëshpëruar në përfaqësuesit e kësaj Partie të cilët kurë nuk ditën të falenderohen.

Në kohën e fundit, gjatë pushimeve shpesh e vizitova të ndjerin.

Bisedonim mbi aktivitetet Egjiptiane që beheshin në Kosovë dhe diasporë, e njoftojsha mbi të arriturat, e ai i kënaqur thoshte: “Jam i kënaqur që munda t’ju tregoj kot, e tani gjeneratat e reja po e vazhdojnë”.

Shoku ynë i dashur, i ndjeri VESEL KODROLLI përjetësisht do të mbetet në kujtimet tona si një ndër personalitetet kryesore që së bashku me shokë ja vuri themel Levizjes sonë Egjiptiane me anë të së cilës arriti që rreth vetes të ketë shumë miqë të cilët e nderuan dhe i shprehën respektin me të thellë për punën historike që ai bëri për të mirën e popullit tonë mbare.

Prandaj, në jemi kërenar që e patëm dhe i gjithë populli ynë, sepse në atë kohë të vështirë pa u hamend në sakrificë i pari u vu në ball të Shoqatës sonë Egjiptiane të Kosovës dhe si Kryetar e udhëheqi një dekadë me radhë. Ai ishte i vyer, i fortë dhe i guximshëm që shpesh edhe e rrezikoi jetën, por nuk u dorëzua kurë për asnjë sfidë.

Ai përherë do të jetë në kujtimet tona dhe puna e tij do të shërbejë si frymëzim me të mirë për femijet tane, për brezat e tjera që do të vijne duke mbjellë kështu ndjenjën e dashurisë ndaj ceshtjes sonë kombëtare.

Lavdi i qoftë, dhe Allahu e shpërbleftë me xhenet.

Me 07.10.2012

Autor : Qerim Abazi